**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

**KOMUNA E DEÇANIT**
MUNICIPALITY OF DECANI –OPSTINA DECANI

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport,

hapë këtë:

# THIRRJE PËR DHURIMIN E ARTEFAKTEVE

Të nderuar qytetarë të komunës së Deçanit me rrethinë!

Për të ndërtuar një koleksion dhe ekspozitë më gjithëpërfshirëse që përfaqëson më mirë komunitetin tonë në tërësi, Muzeu Etnologjik i Deçanit ka nevojë për artefakte.

Ne, do të mbledhim veshje, punime artizanale, libra, katalogë, albume, monografi e punime që i takojnë trashëgimisë kulturore të Deçanit me rrethinë (qoftë Trashëgimi materiale, shoqërore, shpirtërore e artistike).

Objekte këto që ofrojnë një vështrim në jetën e përditshme dhe kulturën e komunitetit lokal në të kaluarën dhe sot janë me interes për Muzeun e Deçanit.

Gjatë kësaj kohe do të presim bashkëpunim nga qytetarët e Deçanit në mënyrë që Muzeu të mbajë një pjesë të historisë të secilit nga ne.

Të interesuarit mund të paraqitën në zyrat e Drejtorisë së Kulturës në Deçan.

**DREJTORI**

Dt.10.02.2023/Deçan